

Popullsia e Shqipërisë

1 Janar 2025


Tiranë, më 12 Qershor 2025: Popullsia e Shqipërisë¹ më 1 Janar 2025 rezulton 2.363.314 banorë, duke pësuar rënie me 1,2 %, krahasuar me 1 Janar 2024.

Rënia e popullsisë është rezultat i dy komponentëve kryesorë demografikë:

- Shtesës natyrore, që për vitin 2024 ishte pozitive me +1.208 lindje më shumë se vdekje;
- Migracionit neto, i cili mbeti negativ me -28.836 persona.

Raporti gjinor në lindje u rrit nga 106,8 në vitin 2023 në 107,8 në 2024.

Fig. 1: Lindjet dhe vdekjet në Shqipëri



¹ Rivlerësim me bazë Cens 2023 të Popullsisë (lutem konsultimin për detaje metodologjike në Aneksin.1)

Treguesit demografikë	1 Janar 2024	1 Janar 2025
Mosha mediane	43,5 vjeç	44,3 vjeç
Raporti gjinor i popullsisë gjithsej (meshkuj për 100 femra)	98,1	97,8
Raporti i varësisë së të rinjve	23,9 %	23,8 %
Raporti i varësisë së të moshuarve	31,1 %	33,3 %
Raporti i varësisë së përgjithshme	55,0 %	57,1 %
*Migracioni neto	-43.761	-28.836

**Bazuar në të dhënat më të mira proxy të mundshme nga vërtetimet statistikore.*

Përlllogaritjet e popullsisë më 1 Janar 2025 tregojnë se vetëm qarku i Tiranës shënoi rritje të popullsisë, krahasuar me një vit më parë me 0,2 %. Uljet më të mëdha të popullsisë u shënuan në qarqet: Shkodër (-2,5 %) dhe Kukës (-2,3 %).

Tirana, Fieri dhe Elbasani kanë peshën më të lartë në popullsinë gjithsej.

Më 1 Janar 2025, Tirana zë rreth 32,2 % të popullsisë gjithsej, duke vazhduar të jetë qarku më i populluar i vendit, ndjekur nga Fieri dhe Elbasani me nga 9,9 % dhe 9,6 % përkatësisht.

Për më shumë informacion dhe për të parë tabelat e detajuara, vizitoni bazën e të dhënave në faqen zyrtare të INSTAT: [Statistikat e Popullsisë](#)

Metodologjia

I. Rivlerësim i popullsisë midis dy Censeve

Censi i Popullsisë dhe Banesave 2023 i cili kishte si synim përmbushjen e nevojave të përdoruesve me informacione thelbësore mbi popullsinë, paraqet një panoramë të demografisë për dekadën, që nga viti 2011. Pas publikimit të rezultateve mbi Censin e Popullsisë dhe Banesave 2023 në Shqipëri, INSTAT ka kryer një vlerësim të përlogaritjes së popullsisë në baza vjetore. Zakonisht ky proces kryhet pas çdo Censi në mënyrë që të sigurohen dhe prodhohen statistika me një cilësi të lartë, duke përdorur informacionin e disponueshëm.

Ky vlerësim u bë i mundur duke u mbështetur edhe nga konsulencë me ekspertë ndërkombëtarë.

Përlogaritjet e popullsisë më 1 Janar kryhen çdo vit nga INSTAT duke pasur si pikë nisje Censin më të fundit. Ato i referohen “popullsisë banuese”, duke përfshirë çdo banues në territorin e Shqipërisë, gjatë periudhës referencë. Popullsia banuese konsideron migrantët ndërkombëtarë (individët që ndryshojnë shtetin e tyre të vendbanimit për një periudhë më shumë se 12 muaj); duke i shtuar numrit të popullsisë imigrantët apo të kthyerit që plotësojnë kushtin e vendbanuesit të zakonshëm dhe duke i zbritur numrin e emigrantëve (personat që largohen nga vendi për më shumë se një vit).

Të dhënat administrative lindje/vdekje konsiderohen të besueshme pasi mbështeten në regjistra (rekorde administrative). Lindjet gjatë periudhës 12 mujore i shtohen popullsisë sipas gjinisë, ndërsa vdekjet i zbriten përkatësisht sipas moshës, gjinisë dhe sipas zonës së banimit - në rastin e Shqipërisë (qarku).

Për lindjet dhe vdekjet: për këtë seri kohore dhe në vijimësi, bëhet e mundur pastrimi i rasteve “fetus morto” (rastet pa asnjë shenjë jete), duke marrë në konsideratë për vlerësimin final vetëm lindjet e gjalla, atribuar përshtatjes metodologjike.

Nisur nga këto evidencime, INSTAT ka kryer më pas vlerësime të përlogaritjeve të popullsisë, në baza vjetore, duke përfshirë informacionin e Cens 2023.

II. Metoda e komponentit të gjeneratës

Përlogaritjet vjetore të popullsisë bazohen në metodën e komponentit të gjeneratës. Kjo është një metodë standarde demografike, e cila përdor një sërë burime të dhënash për komponentët bazë të ndryshimit të popullsisë. Komponentët kryesorë të ndryshimit të popullsisë janë përmbledhur si më poshtë vijon:

i. Shtesa Natyrore (lindjet dhe vdekjet)

Si pikënisje për përlogaritjen e popullsisë banuese u konsiderua numri i popullsisë banuese që më 1 Janar të vitit të mëparshëm. Lindjet gjatë periudhës 12 mujore i janë shtuar popullsisë, ndërsa vdekjet janë zbritur respektivisht sipas moshës, gjinisë dhe qarkut respektiv.

ii. Lindjet

Ndryshimet në popullsi si pasojë e lindjeve:

Lindjet e gjalla që ndodhin nga 1 Janari në 31 dhjetor të vitit të kaluar, i shtohen popullsisë zero vjeç sipas gjinisë dhe i shpërndahen qarkut ku lindja është regjistruar në zyrën e gjendjes civile.

Të dhënat e lindjeve:

Të dhënat e lindjeve sipas karakteristikave bazë demografike sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e lindjeve të banuesve në Shqipëri. Konsiderohen të gjitha lindjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh lindjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve), edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile, pranë ish-vendbanimeve të tyre.

Regjistrimet e vona të lindjeve:

Kryhet një rregullim i vogël i numrit të lindjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha lindjet e ndodhura në periudhën referencë. Numri i lindjeve të regjistruara vonë, në vitin e mëparshëm janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të lindjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

iii. Vdekjet

Ndryshimet në popullsi si pasojë e numrit të vdekjeve:

Vdekjet e regjistruara në Shqipëri nga 1 Janari në 31 dhjetor të vitit të kaluar i zbriten popullsisë sipas gjinisë, moshës dhe qarkut të vendbanimit.

Të dhënat e vdekjeve:

Të dhënat e vdekjeve, sipas karakteristikave bazë demografike sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e vdekjeve të banuesve në Shqipëri. Konsiderohen të gjitha vdekjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh vdekjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve), edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile pranë ish-vendbanimeve të tyre.

Regjistrimet e vona të vdekjeve:

Bëjmë një rregullim të vogël të numrit të vdekjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha vdekjet e ndodhura në periudhën referencë. Numri i vdekjeve të regjistruara vonë, në vitin e mëparshëm janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të vdekjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

iv. Migracioni neto

Lëvizjet e njerëzve që hyjnë dhe dalin nga vendi (migracioni ndërkombëtar) është komponenti më i vështirë për t'u matur, duke qenë se Shqipëria nuk ka ende një regjistër popullsie. Në këtë mënyrë, ne përdorim të dhënat më të mira "proxy" për vlerësimin e migracionit, duke u bazuar kryesisht në të dhënat e mbledhura nga Moduli i Migracionit, nëpërmjet Anketës së Forcave të Punës, kombinuar me koeficientët e projeksioneve të popullsisë.

v. Lëvizjet e brendshme

Lëvizjet e popullsisë brenda territorit të vendit, gjithashtu sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile e cila i mundëson këto të dhëna në bazë vjetore. Përfshihen të gjitha lëvizjet e popullsisë të cilat janë shoqëruar me ndryshim të vendbanimit (qarkut) pasqyruar me regjistrim në zyrën e gjendjes civile të vendbanimit të ri të personit. Lëvizjet e brendshme të personave të cilat nuk janë shoqëruar me regjistrim në zyrat e gjendjes civile respektive sipas vendbanimit të ri, nuk mund të merren parasysh.

PËRKUFIZIME

Popullsia banuese: Popullsia që bazohet në konceptin e vendbanimit të zakonshëm. Sipas këtij përkufizimi përfshihen në popullsinë banuese të një viti të gjithë ata persona që banojnë ose kanë si qëllim të banojnë në vend për të paktën 12 muaj pavarësisht shtetësisë së tyre.

Norma e rritjes së popullsisë në 1 Janar: Raporti i rritjes gjithsej të popullsisë përgjatë një viti si rezultat i rritjes së saj natyrore dhe migrimit neto ndaj vitit të mëparshëm shprehur në përqindje.

Mosha mediane: Përfaqëson moshën që ndan një popullsi në dy grupe numerikisht të barabarta; që do të thotë gjysma e njerëzve janë më të rinj se mosha mediane, dhe gjysma tjetër janë më të moshuar.

Raporti gjinor i popullsisë: Raporti i meshkujve ndaj femrave në një periudhë të dhënë, zakonisht i shprehur si numri i meshkujve për çdo 100 femra.

Raporti i varësisë së të rinjve: Raporti i numrit të personave nën moshën e punës (0-14 vjeç) me numrin e personave që janë në moshë për të punuar (nga 15 deri në 64 vjeç), shprehur në përqindje

Raporti i varësisë së të moshuarve: Raporti i numrit të personave të moshuar, mbi moshën e punës (65+ vjeç), me numrin e personave që janë në moshë për të punuar (nga 15 deri në 64 vjeç), shprehur në përqindje.

Raporti i varësisë së përgjithshme: Raporti i numrit të personave nën moshën e punës (0-14 vjeç) dhe personave të moshuar, mbi moshën e punës (65+ vjeç) me numrin e personave që janë në moshë për të punuar (nga 15 deri në 64 vjeç), shprehur në përqindje.

Migracioni neto: Ky tregues shprehet si diferencë ndërmjet imigrantëve (të ardhurit) ndaj emigrantëve (të larguarit), në një periudhë kohe të dhënë (I-E).

Shtesa natyrore e popullsisë: Shpreh rritjen/rënien e popullsisë, si rezultat i proceseve biologjike (lindjeve dhe vdekjeve) të saj, gjatë një periudhe kohe. Ky tregues shprehet si diferencë ndërmjet lindjeve dhe vdekjeve.

Raporti gjinor në lindje: Raporti i meshkujve ndaj femrave të lindur në një periudhë të dhënë zakonisht i shprehur si numri i meshkujve për çdo 100 femra.

Lindje e gjallë: Lindjet e fëmijëve që shfaqin ndonjë shenjë jete e cila tregon numrin e përgjithshëm të lindjeve duke përfshirë lindjet e vdekura.

Vdekje: Nënkupton zhdukjen e përhershme të të gjitha shenjave të jetës, në çdo kohë pasi ka ndodhur një lindje e gjallë.

Vdekjet e vonshme të fetusit ose lindjet e vdekura: Nënkupton nxjerrjen nga nëna e një fetusit të vdekur pas kohës në të cilën normalisht do të supozohej se është i aftë për ekzistencë të pavarur jashtë mitrës. Foshnjat që lindin të gjallë, por që vdesin menjëherë pas lindjes, përfshihen nga kjo kategori.